



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 225, datë 22.11.2019

PËR
MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE NDAJ BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me kërkesat e neneve 2 dhe 19 të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në vijim të procesit të ndjekjes së Fondit të Kompensimit si dhe në zbatim të vendimeve të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018 dhe nr. 118, datë 06.06.2019, konstaton se:

Nga inspektimi i kryer pranë shoqërive të sigurimit dhe BSHS-së, situata e detyrimeve në 31.08.2019 për dëmet e papaguara për ngjarjet pas 1 janar 2014, paraqitet si më poshtë:

Tab. Nr. 1

Sipas statusit të praktikës	Nr.	vlerë
1. Dëme të miratuara por të papaguara	85	133,345,556
1.1 Dëme të miratuara në proces pagese	75	88,391,559
<i>Në proces pagese dhe marrëveshje</i>	10	32,218,767
<i>Mbetur për tu paguar</i>	65	56,172,792
1.2 Dëme me vendime gjyqësore të formës së prerë	10	44,953,997
2. Dëme në proces	292	607,580,992
2.1 Dëme në proces trajtimi	108	82,628,099
2.1 Dëme në proces gjyqësor shkallë e parë	102	179,143,644
2.2 Dëme në proces gjyqësor Apel dhe Shkallë e lartë	82	345,809,249
Detyrimi për Dëme Pezull Fond Kompensimi	377	740,926,548

Referuar pagesave të bëra deri më 31.08.2019 në vlerën prej 184,138,184 lekë, si dhe detyrimet për Fond Kompensimi sipas Vendimit të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018, nevoja për fond është në vlerën 85,559,788 lekë.

Sipas vendimit të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018, është parashikuar fondi prej 100,000,000 lekë, me qëllim pagesën e dëmeve për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim.

Në këto kushte, fondi i miratuar me vendimin e AMF-së është i mjaftueshëm për pagesën e dëmeve për këto ngjarje.

Gjithashtu, nga ky inspektim evidentohen çështje që lidhen me mosraportimin apo raportimin jo të saktë në Sistemin Elektronik të Administrimit të Dëmeve të Fondit të Kompensimit.

Ky sistem funksionon sipas Rregullores së miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së nr. 03, datë 11.01.2019.

Në vendimin e Bordit nr. 118, datë 06.06.2019, pika 1.3, përcakton detyrimin që BSHS të hartojë formularët e raportimit periodik, në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, duke pasqyruar saktë detyrimin e Fondit të Kompensimit si dhe pagesat e kryera nga shoqëritë e sigurimit.

Nga raportimet periodike deri në periudhën janar-tetor 2019, detyrimi i Fondit të Kompensimit nuk pasqyrohet saktë, sipas vendimit të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018.

Sipas detyrimit të mbetur më 31.12.2018, si dhe fondit të miratuar për vitin 2019, detyrimi për Fond Kompensimi për vitin 2019, është në vlerën 946,495,929 lekë.

Problematikë aktuale vazhdon të jetë mospranimi nga anëtarët e BSHS-së të detyrimit të Fondit të Kompensimit të vitit 2019, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 260, datë 28.12.2018.

Autoriteti me shkresat nr. 3359-3366 prot, datë 24.10.2019, i ka bërë me dije shoqërive të sigurimit për nivelin e pagesave, duke kërkuar nga ana e tyre pagesat me ritme për përmbushjen e detyrimit të Fondit të Kompensimit për vitin 2019, sipas vendimeve të Autoritetit.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Byroja Shqiptare e Sigurimit të pasqyrojë saktë detyrimin e Fondit të Kompensimit, për vitin 2019, në vlerën totale 946,495,929 lekë.
2. Të hartojë formularët e raportimit periodik, për periudhën në vazhdim, në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, duke pasqyruar saktë detyrimin e Fondit të Kompensimit siç pasqyrohet në pikën 1 më sipër.

3. Shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS-së të përfundojnë pagesat e praktikave të miratuara të papaguara të konstatuara nga inspektimi në vend.
4. Bazuar në nenin 31, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të sanksionohen me gjobë në masën 50,000 lekë, personat përgjegjës të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të BSHS-së, lidhur me mospërputhjen e të dhënave të praktikave të Fondit të Kompensimit vënë në dispozicion nga ana e shoqërive me të dhënat e raportuara në sistemin Elektronik të Administrimit të Dëmeve, miratuar me vendimin e APA të BSHS-së nr. 3, datë 11.01.2019.
5. Shoqëritë e sigurimit të vijojnë me pagesat e Fondit të Kompensimit, duke përmbushur detyrimin e këtij fondi sipas vendimeve të Bordit.
6. Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit brenda vitit 2019, të bëjnë sistemimin e praktikave të paguara (të përfunduara), duke i plotësuar me dokumentacionin përkatës si dhe duke i pasqyruar këto në përlogaritjen e detyrimit të saktë të Fondit të Kompensimit.
7. Byroja Shqiptare e Sigurimit të depozitojë informacion mbi zbatimin e kërkesave të mësipërme deri më 6 dhjetor 2019.
8. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI